



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



ARRU

№ prot./Pret. Buletin No. 335
Drejtoria
Data: 01/06/2026

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 3.6 dhe nenin 21 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, nenin 28 të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, si dhe nenin 5 dhe nenin 13 të Rregullores Nr. 10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë, nenin 18 të Rregullores Nr. 06/2016 për Ndërprerje nga Shërbimet e Ujit në Kosovë dhe nenin 4 të Rregullores Nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit në Kosovë, me qëllim të mbrojtjes së furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm gjatë sezonit veror, me datën 01.06.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndërmarrjen e masave të përkohshme për ndalimin e keqpërdorimit të ujit të pijshëm gjatë sezonit veror

1. Ndalohet përdorimi i ujit të pijshëm nga sistemi publik i furnizimit për:
 - 1.1. pastrimin e rrugëve, trotuareve dhe sipërfaqeve të tjera publike apo private;
 - 1.2. larjen e automjeteve;
 - 1.3. ujitjen e kopshteve, livadheve dhe tokave bujqësore;
 - 1.4. mbushjen e pishinave;
 - 1.5. çdo përdorim tjetër që nuk ka për qëllim nevojat themelore të konsumit njerëzor.
2. Të gjithë ofruesit e shërbimeve të ujit obligohen që:
 - 2.1. të rrisin monitorimin dhe kontrollin në terren;
 - 2.2. të identifikojnë dhe evidentojnë rastet e keqpërdorimit të ujit të pijshëm;
 - 2.3. të ndërmarrin masa për ndërprerjen e furnizimit me ujë në rastet e shfrytëzimit që bie në kundërshtim me pikën 1 të këtij vendimi dhe legjislacionin në fuqi,
 - 2.4. në rastet e ndërprerjes së furnizimit me ujë sipas pikes 2.3 të këtij vendimi, për ndërprerjen dhe rilidhjen e shërbimit do të aplikohen tarifatat sipas legjislacionit dhe tarifave në fuqi;
 - 2.4. të bashkëpunojnë me komunat dhe institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi;
 - 2.5. të zhvillojnë fushata vetëdijësuese për përdorimin racional të ujit të pijshëm.

A r s y e t i m

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara me Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe aktet nënligjore në fuqi, ka vlerësuar se gjatë sezonit veror paraqitet rritje e konsiderueshme e konsumit të ujit të pijshëm, e cila ndikon drejtpërdrejt në stabilitetin dhe sigurinë e furnizimit publik me ujë.

Nga monitorimet dhe raportimet e ofruesve të shërbimeve të ujit është konstatuar se një pjesë e konsiderueshme e ujit të pijshëm përdoret për qëllime që nuk lidhen me nevojat themelore të konsumit njerëzor, përfshirë larjen e automjeteve, ujitjen e sipërfaqeve të gjelbra dhe tokave bujqësore, mbushjen e

pishinave dhe përdorime tjera të ngjashme. Këto veprime ndikojnë drejtpërdrejt në zvogëlimin e kapaciteteve furnizuese dhe rrezikojnë furnizimin e rregullt të konsumatorëve me ujë të pijshëm.

Sipas nenit 28 paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, furnizimi i popullatës me ujë të pijshëm ka prioritet ndaj çdo përdorimi tjetër të ujit. Po ashtu, neni 6 paragrafi 1.4 i po këtij ligji përcakton obligimin që ujërat të shfrytëzohen në mënyrë racionale dhe të shmangët çdo efekt negativ apo rrezik për shëndetin publik dhe mjedisin. Ndërsa, neni 26 paragrafi 2 ndalon kryerjen e veprimeve që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes ujore dhe cenimin e regjimit të furnizimit me ujë.

Në kuptim të këtyre dispozitave, përdorimi i ujit të pijshëm për qëllime të tjera jashtë destinimit parësor të tij, edhe në rastet kur konsumi regjistrohet përmes ujëmatësit dhe faturohet, nuk e përjashton karakterin e keqpërdorimit kur një përdorim i tillë rrezikon furnizimin e përgjithshëm publik me ujë të pijshëm.

Për më tepër, sipas Rregullores Nr. 10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë, ofruesit e shërbimeve obligohen të sigurojnë furnizim të vazhdueshëm, të sigurt dhe cilësor me ujë të pijshëm për konsumatorët. Gjithashtu, Rregullorja Nr. 06/2016 për Ndërprerje nga Shërbimet e Ujit në Kosovë autorizon ofruesit e shërbimeve që të ndërpresin furnizimin në rastet e përdorimit të paautorizuar apo keqpërdorimit të ujit.

Duke marrë parasysh interesin publik, mbrojtjen e shëndetit publik, sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm dhe obligimet ligjore të ofruesve të shërbimeve të ujit, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit ka vlerësuar se nxjerrja e këtij vendimi është masë e domosdoshme, proporcionale dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe për këto arsye, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe zbatohet gjatë sezonit veror, në periudhën nga 01.06.2026 deri më 31.10.2026.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi u dorëzohet:

- Arkivit të ARRU-së;
- Kryeshfave Ekzekuti të të gjithë KRU;
- Departamenteve të ARRU-së.



Drejtoresha

Hajrije MORINA